



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 201

Tiranë – E martë, 24 nëntor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 122/2015 datë 12.11.2015	Për ratifikimin e protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.....	13179
Ligj nr. 123/2015 datë 12.11.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për Mbrojtjen Shoqërore.....	13181
Ligj nr. 124/2015 datë 12.11.2015	Për efikasitetin e energjisë.....	13190
Vendim i Kuvendit nr. 98/2015, datë 19.11.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	13201
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 946, datë 24.11.2015	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Kristi Maze, në spitalin “Papa Giovanni XXIII”, në Bergamo, Itali.....	13202



LIGJ
Nr. 122/2015

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NR. 15 TË KONVENTËS EUROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Protokollin nr. 15 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9323, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLLI NR. 15
QË AMENDON KONVENTËN PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

Strasbourg, 24.6.2013

KONVENTA
PROTOKOLLET NR. 1, NR. 4, NR. 6,
NR. 7, NR. 12, NR. 13

Raport shpjegues

Frëngjisht

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut
(CDDH)

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe palët e tjera kontraktuese të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive

Themelore, nënshkruan në Romë, më 4 nëntor 1950 (që këtej e tutje referuar si “Konventa”), si palë nënshkruese në këtë dokument,

duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar në konferencën e nivelit të lartë lidhur me të ardhmen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të mbajtur në Brajton (Brighton), më 19 dhe 20 prill 2012, si dhe deklaratat e miratuara në konferencat e zhvilluara në Interlaken, më 18 dhe 19 shkurt 2010 dhe në Izmir, më 26 dhe 27 prill 2011;

duke marrë në konsideratë Opinionin nr. 283 (2013), miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, më 26 prill 2013;

duke marrë në konsideratë nevojën për t’u siguruar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (që këtej e tutje referuar si “Gjykata”), mund të vazhdojë të luajë rolin e saj të shquar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Në fund të preambulës së Konventës shtohet një përkrahje që do të lexohet si më poshtë:

“Duke konfirmuar se Palët Kontraktuese, në përputhje me parimet e subsidiarititetit, kanë përgjegjësinë parësore të sigurojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë dhe protokollet e saj, dhe duke vepruar në këtë mënyrë ato gëzojnë një shkallë vlerësimi që i nënshtrohet juridiksionit mbikëqyrës të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të përcaktuar nga kjo Konventë.”.

Neni 2

1. Në nenin 21 të Konventës, shtohet paragrafi 2, me përmbajtjen si më poshtë:

“Kandidatët do të jenë më të rinj se 65 vjeç, në datën në të cilën lista e tre kandidatëve është kërkuar nga Asambleja Parlamentare, në vijim të nenit 22.”.

2. Paragrafët 2 dhe 3, të nenit 21 të Konventës, do të shndërrohen përkatësisht në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 21.

3. Paragrafi 2 i nenit 23 të Konventës hiqet. Paragrafët 3 dhe 4, të nenit 23, bëhen përkatësisht paragrafët 2 dhe 3, të nenit 23.



Neni 3

Në nenin 30 të Konventës, hiqen fjalët “në rast se njëra prej palëve të objekteve të çështjes”.

Neni 4

Në nenin 35, paragrafi 1 i Konventës, fjalët “brenda një periudhe gjashtëmujore” zëvendësohen me fjalët “brenda një periudhe katërmujore”.

Neni 5

Në nenin 35, paragrafi 3, nënparagrafi “b” i Konventës hiqen fjalët “dhe në rast se asnjë çështje nuk mund të refuzohet për këtë arsye, që nuk është konsideruar në mënyrë të përshtatshme nga një gjykatë vendase”.

Neni 6

Dispozita përfundimtare dhe transitore

1. Ky protokoll do të jetë i gatshëm për nënshkrim nga palët kontraktuese të Konventës, që mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur, nga:

a) nënshkrimi pa rezervë për sa i përket ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

b) nënshkrimi që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumenti i ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohet në Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 7

Ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe tremujore, pas datës në të cilën të gjitha palët kontraktuese të Konventës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë të lidhura nga protokollit, në përputhje me nenin 6.

Neni 8

1. Amendamentet e paraqitura nga neni 2 i këtij protokollit do të vlejnjë vetëm për kandidatët në listat që i dorëzohen Asamblesë Parlamentare nga Palët Kontraktuese, sipas nenit 22 të Konventës, pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit.

2. Amendamenti i paraqitur nga neni 3 i këtij protokollit nuk vlen për ndonjë çështje të mbartur

në të cilën njëra nga palët ka kundërshtuar, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një propozim të Dhomës pranë Gjykatës për të hequr dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

3. Neni 4 i këtij protokollit do të hyjë në fuqi pas skadimit të një periudhe gjashtëmujore, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit. Neni 4 i këtij protokollit nuk do të jetë i vlefshëm për aplikimet, për të cilat vendimi përfundimtar në kuptim të nenit 35, paragrafi 1 të Konventës, është marrë përpara datës së hyrjes në fuqi të nenit 4 të këtij protokollit.

4. Të gjitha dispozitat e tjera të këtij protokollit nuk do të aplikohen nga data e hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 7.

Neni 9

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Palët Kontraktuese të Konventës, lidhur me:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimt e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit ose miratimit;

c) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, në përputhje me nenin 7; dhe

d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër lidhur me këtë protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, e kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 24 qershor 2013, në anglisht dhe në frëngjisht, të dyja tekstat njëjloj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'ia përcjellë kopjet e certifikuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës dhe Palëve Kontraktuese të Konventës.



LIGJ
Nr. 123/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË PËR MBROJTJEN
SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9324, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHJE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm Palë Kontraktuese),

me dëshirën për t'i rregulluar marrëdhëniet e ndërsjella në fushën e mbrojtjes shoqërore, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimi i termave

1) Përkufizimi i termave, në kuptim të kësaj marrëveshjeje, është si më poshtë vijon:

1. “Dispozita ligjore”, ligje, akte nënligjore dhe dispozita të tjera, që u referohen fushave të caktuara të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje;

2. “Organ kompetent”, ministritë që janë kompetente në lidhje me dispozitat ligjore të nenit 2, paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje;

3. “Institucionet”, në Republikën e Shqipërisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Kujdesit Shëndetësor.

Në Republikën e Maqedonisë, Fondi për Sigurimet Shoqërore dhe të Invaliditetit të Maqedonisë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në Maqedoni.

4. “Institucioni kompetent”, institucioni tek i cili personi është i siguruar gjatë kohës së paraqitjes së kërkesës për përfitim ose prej të cilit ka apo mund të ketë të drejtën e përfitimit;

5. “I siguruari”, personi që është i siguruar apo ka qenë i siguruar sipas dispozitave ligjore të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje.

6. “Anëtar i familjes”, anëtari i familjes përcaktohet sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese, dispozitat e së cilës zbatohen.

7. “Vendbanim”, vendbanim i përhershëm.

8. “Vendqëndrim”, vendqëndrimi i përkohshëm.

9. “Periudha e sigurimit”, për Republikën e Shqipërisë: Çdo periudhë e kontributeve të paguara, vitet e punës, aktiviteti profesional, si dhe çdo periudhë e tillë e ekuivalentuar me periudhën e sigurimit sipas legjislacionit shqiptar.

Për Republikën e Maqedonisë: periudhat për të cilat janë paguar kontributet dhe periudhat që njihen si të tilla.

10. “Përfitim”, përfitimi në natyrë dhe përfitimi në para.

11. “Përfitimi në natyrë” janë përfitimet që garantohen sipas dispozitave ligjore të secilës palë kontraktuese, përveç përfitimeve në para.

12. “Përfitimi në para”, pensioni dhe përfitimet e tjera në para, duke përfshirë edhe rimbursimet, kompensimet, indeksimet dhe rritjet sipas dispozitave ligjore të përcaktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

13. “Ofrimi i ndihmës së shpejtë shëndetësore”, përfitimi në natyrë që s’mund të shtyhet, pasi në të kundërt do të rrezikohet seriozisht jeta dhe shëndeti i personit.

2. Termat e tjerë, që nuk janë përfshirë në paragrafin 1 të këtij neni, do të trajtohen sipas



përkufizimit që ata kanë në dispozitat ligjore të palëve kontraktuese.

Neni 2

Hapësirat ligjore

1. Kjo marrëveshje bazohet në:

1.1 Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë për:

1.1.1 Sigurimet shoqërore për personat e punësuar, në lidhje me:

1.1.1.1 paaftësinë e përkohshme për punë për shkak të sëmundjes;

1.1.1.2 barrë lindjen;

1.1.1.3 pleqërinë, invaliditetin, si dhe humbjen e mbajtësit të familjes;

1.1.1.4 aksidentin në punë dhe sëmundjen profesionale.

1.1.2 Sigurimet shoqërore për personat e tjerë ekonomikisht aktivë (të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit), në lidhje me:

1.1.2.1 barrë lindjen;

1.1.2.2 pleqërinë, invaliditetin, si dhe humbjen e mbajtësit të familjes;

1.1.3 kujdes të detyrueshëm shëndetësor në rast sigurimi të detyrueshëm.

1.2 Dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë, për:

1.2.1 sigurimin për pension dhe invaliditet;

1.2.2 sigurimin shëndetësor, kujdesin shëndetësor dhe barrë lindjen;

1.2.3 aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për të gjitha dispozitat ligjore me të cilat ndryshohen ose plotësohen dispozitat ligjore të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo marrëveshje do të zbatohet edhe për dispozitat ligjore që do t'i zgjerojnë skemat aktuale me kategori të reja përfituesish, në rast se në lidhje me këtë nuk ka kundërshtime nga pala kontraktuese, e cila ka ndryshuar legjislacionin e saj, për të cilën pala tjetër kontraktuese do të njoftohet brenda gjashtë muajve nga publikimi zyrtar i akteve të cilësuar.

4. Kjo marrëveshje nuk zbatohet për dispozitat ligjore me të cilat parashikohet degë e re e sigurimeve shoqërore, vetëm nëse për këtë qëllim nuk arrihet marrëveshje midis institucioneve kompetente të palëve kontraktuese.

Neni 3

Fusha e zbatimit për personat

Nëse nuk është parashikuar ndryshe, kjo marrëveshje, do të zbatohet për të gjithë personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të secilës prej palëve kontraktuese dhe për personat e tjerë që i gëzojnë këto të drejta prej tij.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Nëse nuk është parashikuar ndryshime me këtë marrëveshje, të gjithë personat e përfshirë në këtë marrëveshje do të trajtohen në mënyrë të barabartë prej palëve kontraktuese në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për plotësimin e kushteve dhe pagesën e përfitimeve që rrjedhin drejtpërdrejt prej legjislacionit të palëve kontraktuese ose sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Transferimi i përfitimeve

1. Përfitimet e fituara në bazë të legjislacionit të njëjës palë kontraktuese nuk mund të reduktohen, ndryshohen, ndërpriten apo anulohen për shkak se përfituesi ka vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe me këtë marrëveshje.

2. Për personat që kanë të drejtën e përfitimit nga njëra palë kontraktuese, transferimi i përfitimit sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet në kushte të njëjta edhe në rastet kur ata jetojnë në një shtet të tretë.

3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për rastet e pensionit minimal.

PJESA II

DISPOZITAT LIGJORE TË ZBATUESHME

Neni 6

Dispozitat e përgjithshme

Detyrimi i personit për t'u siguruar sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet në bazë të dispozitave ligjore të palës kontraktuese në territorin e të cilit ai punon. Ky sigurim vlen edhe në rastet kur adresa e punëdhënësit gjendet në territorin e palës tjetër kontraktuese, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me dispozitat e neneve 7 dhe 8 të kësaj marrëveshjeje.



Neni 7

Dispozita të posaçme

1. Në rast se punëdhënësi me adresë në territorin e njëres palë kontraktuese dërgon një punonjës në territorin e palës tjetër kontraktuese, për të, jo më shumë se 24 muaj kalendarikë prej ditës së dërgimit, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet.

2. Në rastet kur personi që ushtron aktivitet të pavarur në territorin e njëres palë kontraktuese shkon përkohësisht për të ushtruar aktivitetin në palën tjetër kontraktuese, për të, jo më shumë se 12 muaj kalendarikë prej ditës së largimit të tij, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese sikur ai ta ushtrojë këtë aktivitet në territorin e vet.

3. Në rastet kur një ndërmarrje e transportit ajror apo tokësor me adresë në territorin e njëres palë kontraktuese dërgon një punëtor në territorin e palës tjetër kontraktuese, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet.

4. Për ekuipazhin e anijeve dhe të punësuarit e tjerë në anije, zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese, flamurin e së cilës mban anija që lundron.

5. Për personat që ushtrojnë aktivitetin e ngarkimit, shkarkimit, riparimit apo mbikëqyrjes së anijes në portet e palës tjetër kontraktuese, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese të cilës i përket porti.

6. Nëse një ndërmarrje me adresë në territorin e njëres palës kontraktuese, dërgon punëtorë në filialin e saj në territorin e palës tjetër kontraktuese, për të do të zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet; për një periudhë kohore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

7. Për punonjësit e administratës publike dhe shtetërore, përfaqësuesit zyrtarë dhe personat që kanë të njëjtën status me ta të dërguar në shtetin tjetër kontraktues, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese që i ka dërguar.

8. Mund të zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese prej paragrafit 1, 2 dhe 6 të këtij neni, me përjashtim të kërkesës së përbashkët të punëdhënësit dhe të të punësuarit, respektivisht me kërkesë të personit që ushtron aktivitet të

pavarur dhe me miratimin e organit kompetent të palës tjetër kontraktuese, që të ketë mundësi për të vazhduar edhe 12 muajt e tjerë.

Neni 8

Punonjësit e misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore

1. Për punonjësit e misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore dhe personat që kanë të njëjtën status me ta, si dhe të punësuarit si shërbime private shtëpiake tek anëtarët e këtyre misioneve dhe përfaqësive, të dërguara në territorin e palës tjetër kontraktuese, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese që i ka dërguar.

2. Për punonjësit prej paragrafit 1 të këtij neni që nuk janë dërguar, zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese në të cilën janë punësuar, ndërsa misionet diplomatike, respektivisht përfaqësitë konsullore, d.m.th. anëtarët e tyre që i kanë punësuar, janë të detyruar t'u përmbahen dispozitat ligjore të atij shteti që janë të vlefshme edhe për punëdhënësin.

3. Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, të punësuarit, të cilët janë shtetas të palës kontraktuese që i përket misionit diplomatik, respektivisht përfaqësisë konsullore, kanë mundësi që në një afat prej 3 muajsh nga dita e punësimit të vendosin për zbatimin e dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese.

Neni 9

Përjashtimet

Me kërkesë të përbashkët nga i punësuarit dhe punëdhënësit të tij, respektivisht personi që ushtron aktivitet të pavarur, organet kompetente të palës kontraktuese mund t'i përcaktojnë përjashtimet prej dispozitave të neneve 7 dhe 8 të kësaj marrëveshjeje dhe gjatë kësaj duhet të merren parasysh lloji dhe rrethanat e punësimit.

PJESA III

DISPOZITA TË POSAÇME

KREU 1

SËMUNDJET DHE BARRËLINDJA

Neni 10

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Periudhat e sigurimit, të plotësuara sipas dispozitat ligjore të të dyja palëve kontraktuese, kur kjo nevojitet, bashkohen për realizimin e së



drejtës së përfitimit dhe përcaktimin e kohëzgjatjes së këtij përfitimi, me kusht që ato të mos mbivendosen.

Neni 11

Përfitimi në natyrë

1. Personi i cili i plotëson për të drejtën e përfitimit në natyrë sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, ka të drejtën e kujdesit shëndetësor nga ana e institucionit ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin e tij, në masën, llojin dhe mënyrën e përfitimit sipas dispozitave ligjore që janë të vlefshme për atë institucion, sikur të jetë i siguar tek ai, por për një periudhë kohore të përcaktuar sipas dispozitave ligjore që janë të vlefshme për institucionin kompetent, i cili ka përgjegjësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor, me kusht që:

1.1 të ketë vendbanim të përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese; ose

1.2 të ketë vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, sipas nenit 7, paragrafët 1, 2, 3, 6 dhe 7 dhe nenit 8, paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje; ose

1.3 gjendja e tij gjatë kohës së vendqëndrimit te pala tjetër kontraktuese kërkon ofrimin urgjent të ndihmës shëndetësore, me kusht që personi të mos ketë shkuar për trajtim shëndetësor te pala tjetër kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen edhe për anëtarin e familjes që ka vendbanim në territorin e palës tjetër kontraktuese.

3. Personi, i cili do të marrë miratimin nga institucioni kompetent i njëjës palë kontraktuese që të dërgohet për trajtim mjekësor në territorin e palës tjetër kontraktuese, përkatësisht kur e kërkon gjendja e tij shëndetësore, ka të drejtën e përfitimit në natyrë nga institucioni që ndodhet në vendqëndrimin e tij të përkohshëm, sipas dispozitave ligjore që vlejné për atë institucion, sikur të jetë i siguar tek ai, por në ngarkim të institucionit kompetent.

4. Për lejimin e përdorimit të protezave, pajisjeve ortopedike ose aparateve të tjera të ngjashme me to dhe përfitimet në natyrë, që kanë vlerë të madhe, nevojitet miratimi paraprak i institucionit kompetent, përveç rasteve kur ofrimi i atyre shërbimeve është urgjent, duke marrë në konsideratë jetën dhe shëndetin e personit.

Lista e shërbimeve të sipërpërmendura do të

përcaktohet me marrëveshje administrative sipas nenit 30 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Përfitimet në para

Përfitimi sipas nenit 11 të kësaj marrëveshjeje, si dhe në rastet e barrëindjes, miratohet nga institucioni kompetent sipas dispozitave ligjore që ajo po zbaton.

Neni 13

Përfitimet e pensionistëve

1. Për pensionistët që kanë përfituar pensionin sipas dispozitave ligjore të të dyja palëve kontraktuese, në mënyrë ekskluzive do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese në të cilën përfituesi ka vendbanimin e tij.

2. Përfituesi sipas paragrafit 1 të këtij neni, të drejtën e përfitimit në natyrë e realizon nga institucioni kompetent i palës kontraktuese ku ka vendbanimin e tij.

3. Për pensionistët që kanë përfituar pensionin sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, të cilët kanë vendbanim të përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese, e drejta e përfitimit në natyrë sigurohet sipas dispozitave ligjore të palës kontraktuese në territorin e së cilës ka vendbanimin, sikur e drejta për pension të jetë realizuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore, por në ngarkim të institucionit kompetent.

4. Përfituesi i pensionit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, me vendbanim të përhershëm në njërin nga palët kontraktuese, gjendja e të cilit gjatë kohës së qëndrimit në palën tjetër kontraktuese, kërkon sigurimin e menjëhershëm të përfitimit në natyrë, ka të drejtën e këtij përfitimi sipas dispozitave ligjore dhe në ngarkim të institucionit të palës tjetër kontraktuese.

5. Dispozitat e paragrafit 1 deri te 4 të këtij neni zbatohen dhe për anëtarët e familjes së përfituesit, në rast se banojnë me të dhe nuk janë të siguar sipas ndonjë skeme tjetër.

Neni 14

Institucioni kompetent që siguron përfitimin në natyrë

Për rastet e neneve 11 dhe 13 të kësaj marrëveshjeje, përfitimin në natyrë e siguron në:



1. Republikën e Shqipërisë - Instituti i Kujdesit Shëndetësor;

2. Republikën e Maqedonisë - Shërbimi Rajonal i Fondit për Sigurimin Shëndetësor të Maqedonisë.

Neni 15

Rimbursimi i shpenzimeve

1. Institucioni kompetent do t'ia rimbursojë institucionit tjetër kompetent shpenzimet për përfitimet në natyrë, të dhënat për personat sipas nenit 11, paragrafët 1, 3 dhe 4 dhe nenit 13, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve administrative. Institucionet do të bien dakord për mënyrën e rimbursimit të shpenzimeve në bazë të vlerës reale të shpenzimit ose shumës fikse.

2. Rimbursimet e shpenzimeve për anëtarët e familjes të parashikuar në nenin 11, paragrafi 2, do të kryhen mbi bazën e një shume fikse për të cilën institucionet do të bien dakord në vijim.

KREU 2

PËRFTIMI I PENSIONIT TË PLEQËRISË, INVALIDITETIT DHE FAMILJAR

Neni 16

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Në rast se sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, fitimi, ruajtja ose rinjohja e së drejtës së përfitimit është e kushtëzuar me periudhën plotësuese të sigurimit, organi kompetent i asaj pale kontraktuese, e merr parasysh, nëse është e nevojshme, edhe vjetërsinë e punës të plotësuar sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese, sikur ajo të jetë plotësuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore, me kusht që periudhat të mos mbivendosen, vetëm nëse s'është përcaktuar ndryshe me këtë marrëveshje.

2. Gjatë zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, periudha e sigurimit, që sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese, konsiderohet si periudhë sigurimi me kohë të zgjatur, gjatë përfitimit të së drejtës do të merret parasysh në zgjatjen efitkase.

3. I siguruari në njëjërën palë kontraktuese, i cili dhe me zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni, nuk i plotëson kushtet për të drejtën e përfitimit, institucioni kompetent e merr parasysh edhe vjetërsinë e punës së plotësuar në një shtet të tretë me të cilin të dyja palët kontraktuese kanë nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen shoqërore,

ku është parashikuar bashkimi i periudhave të sigurimit, të plotësuar në shtetet e treta. Nëse me shtetin e tretë ekziston një marrëveshje e lidhur për sigurimet shoqërore, vetëm njëra palë kontraktuese, institucioni i asaj pale kontraktuese për shtetasit e vet e merr parasysh periudhën e sigurimit të plotësuar në shtetin e tretë.

4. Nëse sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, e drejta e përfitimit në kohë të caktuar është kushtëzuar me plotësimin e vjetërsisë së punës sipas profesionit ose punës, apo aktivitetit të caktuar për të cilin ekziston një sistem i posaçëm, institucioni i asaj pale kontraktuese e merr në konsideratë edhe periudhën e sigurimit, që sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese është plotësuar për të njëjtin profesion apo punë, ose sipas të njëjtit sistem.

Neni 17

Periudha e sigurimit më e vogël se 12 muaj

1. Nëse periudha e përgjithshme e sigurimit, e cila sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese merret parasysh në llogaritjen e përfitimit është më e shkurtër se 12 muaj, nuk pranohet e drejta e përfitimit, me përjashtim të rasteve kur, sipas atyre dispozitave ligjore, ekziston e drejta e përfitimit vetëm në bazë të asaj periudhe sigurimi.

2. Periudha e sigurimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, në bazë të të cilit institucioni përgjegjës i njëjës palë kontraktuese nuk e miraton përfitimin, këtë e merr parasysh institucioni kompetent i palës tjetër kontraktuese për fitimin, ruajtjen dhe rinjohjen e së drejtës së përfitimit, si dhe për përcaktimin e masës së këtij përfitimi, sikur periudha e sigurimit të jetë realizuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore.

Neni 18

Përcaktimi i përfitimit të pavarur

Nëse, sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, ekziston e drejta e përfitimit edhe pa zbatimin e nenit 16 të kësaj marrëveshjeje, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese e përcakton përfitimin për periudhën e sigurimit që merret parasysh sipas atyre dispozitave ligjore.



Neni 19

Përcaktimi dhe përllogaritja e pjesës proporcionale të përfitimit

1. Nëse sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese ekziston e drejta e përfitimit vetëm me zbatimin e nenit 16 të kësaj marrëveshjeje, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese e përcakton përfitimin, në mënyrë që:

1.1 Llogarit masën teorike të përfitimit që do t'i kishte takuar, nëse periudha totale e sigurimit që merret parasysh në përllogaritjen e përfitimit, është plotësuar sipas dispozitave ligjore që zbaton. Masa e përfitimit, e cila nuk varet prej kohëzgjatjes së periudhës së sigurimit, merret si masë teorike;

1.2 Në bazë të masës së përllogaritur sipas pikës 1.1 të këtij neni, përcaktohet masa e përfitimit, që është në proporcion me raportin midis periudhës së sigurimit të plotësuar vetëm sipas dispozitave ligjore që ai zbaton dhe periudhës totale të sigurimit që ai merr parasysh në përllogaritjen e përfitimit;

1.3 Përcakton masën e përfitimit në proporcion me periudhën e sigurimit të plotësuar sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese dhe periudhës së saj më të gjatë të sigurimit, në bazë të së cilës përcaktohet masa e përfitimit, në rastin kur periudha totale e sigurimit, që merret parasysh duke zbatuar nenin 16 të kësaj marrëveshjeje është më e madhe se periudha më e gjatë e sigurimit sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, masa e përfitimit llogaritet në bazë të të ardhurave, pagës, normës bazë të sigurimit, d.m.th. kontributeve të paguara për një periudhë të caktuar kohore, institucioni përgjegjës merr parasysh të ardhurat, pagën, normën bazë të sigurimit, d.m.th. kontributet e paguara, vetëm prej periudhës së sigurimit të plotësuar sipas dispozitave ligjore që ai zbaton.

Neni 20

Reduktimi, ndërprerja dhe anulimi i pagesës së përfitimit

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, duhet të merren parasysh dispozitat ligjore të të dyja palëve kontraktuese me të cilat rregullohet reduktimi, ndërprerja ose anulimi i pagesës së përfitimit.

KREU 3

AKSIDENTI NË PUNË DHE SËMUNDJA PROFESIONALE

Neni 21

Aksidentimi gjatë rrugës deri te vendi i punës

1. Personi me vendbanim në territorin e njëjës palë kontraktuese, i cili gjatë rrugës për të shkuar, në punë në bazë të marrëveshjes për punësim ose për ushtrimin e aktivitetit të pavarur në palën tjetër kontraktuese, aksidentohet, ka të drejtën e përfitimit nga aksidenti në punë sipas dispozitave ligjore dhe në ngarkim të palës tjetër kontraktuese.

2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet edhe në rastet e aksidentimit, që pëson personi menjëherë pas skadimit të marrëveshjes së punës, d.m.th. pas ndërprerjes së ushtrimit të aktivitetit të pavarur, rrugës deri te vendbanimi.

Neni 22

Përfitimi në natyrë

1. Personi i cili në bazë të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale ka të drejtën e kujdesit shëndetësor sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, i cili ka vendbanim apo vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, e përfiton këtë kujdes në ngarkim të institucionit kompetent, nga institucioni i asaj zone në të cilën ka vendbanim apo vendqëndrimin, sipas dispozitave ligjore që zbatohen, sikur ai të jetë i siguruar aty.

2. Për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në vlerë më të madhe, zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafi 4 i kësaj marrëveshjeje.

3. Për rastet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, realizimin e së drejtës për kujdes shëndetësor e siguron:

- në Republikën e Shqipërisë - Instituti i Kujdesit Shëndetësor;

- në Republikën e Maqedonisë - Shërbimi Rajonal i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë.

4. Për kompensimin e shpenzimeve të shkaktuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohen dispozitat e nenit 15 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 23

Sëmundja profesionale

1. Nëse përfitimi në rastin e sëmundjes profesionale sipas dispozitave ligjore të njëjës



palë kontraktuese, është kushtëzuar me faktin që sëmundja të jetë përcaktuar për herë të parë nga mjeku në territorin e atij shteti kontraktues, konsiderohet se ai kusht është plotësuar, në rast se ajo sëmundje për herë të parë është konstatuar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

2. Nëse miratimi i përfitimit në rastin e sëmundjes profesionale sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, është kushtëzuar nga sëmundja të jetë përcaktuar për herë të parë nga mjeku në territorin e atij shteti kontraktues, konsiderohet se ai kusht është plotësuar, në rast se ajo sëmundje për herë të parë është konstatuar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

3. Nëse miratimi i përfitimit në rastin e sëmundjes profesionale, sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese është kushtëzuar nga ushtrimi i aktivitetit që mund ta shkaktojë atë sëmundje, të ketë zgatur për një periudhë kohore të caktuar, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese, nëse nevojitet, e merr në konsideratë edhe kohën e ushtrimit të atij aktiviteti sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese.

Neni 24

Përfitimi në para

1. Përfitimi në para në rastet e aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale e miraton, sipas dispozitave të veta ligjore, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese në territorin e së cilës është shkaktuar aksidenti në punë, d.m.th. aty ku për herë të fundit është ushtruar aktiviteti që ka shkaktuar sëmundjen profesionale.

2. Nëse në person i cili në bazë të sëmundjes profesionale ka marrë apo merr përfitime në para, në ngarkim të institucionit kompetent të njëjës palë kontraktuese, për shkak të përkeqësimit të sëmundjes së shkaktuar gjatë ushtrimit të aktivitetit, i cili sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese mund të shkaktojë sëmundje profesionale, paraqet kërkesë për përfitim të institucionit kompetent të palës tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i palës së parë kontraktuese vazhdon edhe më tej t'i mbulojë shpenzimet e përfitimit, pa marrë parasysh përkeqësimin e gjendjes shëndetësore sipas dispozitave ligjore. Institucioni kompetent i palës tjetër kontraktuese miraton përfitimin, në masën e diferencës ndërmjet përfitimit të shkaktuar nga sëmundja dhe përfitimit

për shkak të përkeqësimit të sëmundjes që i takon sipas dispozitave të saj ligjore.

Neni 25

Njoftimi i misionit diplomatik apo përfaqësisë konsullore për aksidentin në punë

Për aksidentimin në punë të shtetasit ose personit të siguruar në njëjën palë kontraktuese, që ka shkaktuar ose mund të shkaktojë vdekje, institucioni kompetent, menjëherë vë në dijeni misionin diplomatik apo përfaqësinë konsullore të palës kontraktuese, shtetas i të cilit është personi i siguruar.

KREU 4

PËRFITIMI NË RAST VDEKJEJE

Neni 26

E drejta e përfitimit

Përfitimi në rast vdekjeje u takon sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese, në të cilin personi që ka ndërruar jetë, ka pasur vendbanimin.

PJESA IV

DISPOZITA TË TJERA

Neni 27

Zbatimi i marrëveshjes

Organet kompetente me marrëveshje administrative i përcaktojnë institucionet zbatuese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 28

Detyrimet e organeve kompetente, ndihma ligjore dhe administrative

1. Organet kompetente të palëve kontraktuese, me marrëveshje administrative e përcaktojnë mënyrën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje që hyn në fuqi në të njëjtën kohë me këtë marrëveshje.

2. Organet kompetente dhe institucionet e palëve kontraktuese do të informohen ndërmjet tyre, në lidhje me:

1.1 të gjitha masat e ndërmarra për zbatimin e kësaj marrëveshjeje;

1.2 të gjitha ndryshimet e dispozitave ligjore që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, organet dhe institucionet kompetente e palëve kontraktuese në mënyrë të ndërsjellë do të ofrojnë ndihmë ligjore dhe administrative falas.



4. Organet dhe institucionet kompetente të palëve kontraktuese, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, do të kontaktojnë ndërmjet tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe me personat e interesuar apo të autorizuarit e tyre.

5. Organet dhe institucionet kompetente të njëjës palë kontraktuese nuk mund ta refuzojnë kërkesën apo aplikime të tjera për shkak se janë shkruar në gjuhën zyrtare dhe me alfabetin e palës tjetër kontraktuese.

6. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, në mënyrë të barabartë do të përdoret gjuha maqedonase me alfabetin e saj dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj.

7. Kontrollat mjekësore që kryhen vetëm në zbatim të dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, por që kanë të bëjnë me personat të cilët kanë vendbanim apo vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, do të kryhen me kërkesën e institucionit, sipas vendbanimit apo vendqëndrimit. Kontrollat mjekësore që kryhen në zbatim të dispozitave ligjore të të dyja palëve kontraktuese, do të kryhen në ngarkim të institucionit sipas vendbanimit apo vendqëndrimit të personit.

8. Ndihma ligjore, deri në ngritjen e procesit gjyqësor, jepet në përputhje me dispozitat që zbatohen për ndihmën juridike në çështjet ligjore civile.

Neni 29

Misionet diplomatike dhe përfaqësitë konsullore

Misionet diplomatike dhe përfaqësitë konsullore të palëve kontraktuese mund t'u drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa autorizim të posaçëm, organeve dhe institucioneve kompetente të palës tjetër kontraktuese për mbrojtjen e interesave të shtetasve të vet.

Neni 30

Përgjashtimi nga shpenzimet administrative

1. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, përgjashtimi ose reduktimi i shpenzimeve administrative, të parashikuara me dispozitat ligjore të njëjës palë kontraktuese, për aplikimet apo dokumentet që dorëzohen në zbatim të dispozitave të saj ligjore, vlen për të njëjtat kërkesa dhe dokumente që dorëzohen sipas dispozitave ligjore edhe për palën tjetër kontraktuese.

2. Dokumentet dhe aplikimet të çfarëdolloji që dorëzohen, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, nuk legalizohen.

Neni 31

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa, deklarata ose çdo mjet ligjor, që në zbatim të kësaj marrëveshjeje apo të dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese, i paraqitet organit, institucionit apo një organizate tjetër kompetente, enti apo institucioni të njëjës palë kontraktuese, konsiderohet si të jetë paraqitur pranë organit përkatës të palës tjetër kontraktuese.

2. Kërkesa për përfitim, e paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore të njëjës palë kontraktuese, në të njëjtën kohë konsiderohet si kërkesë për të njëjtin përfitim edhe sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese.

3. Kërkesa, deklarata apo mjeti ligjor, që në zbatim të dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese duhet t'i paraqitet organit, institucionit, ndonjë organizate tjetër kompetente, enti ose institucioni të asaj palë kontraktuese, brenda të njëjtit afat kohor mund të paraqitet pranë institucionit përkatës të palës tjetër kontraktuese.

4. Në rastet e paragrafit 1 deri 3 të këtij neni, organi, institucioni ndonjë organizatë tjetër kompetent ose enti, pa vonesë, përcjell kërkesën, deklaratën apo mjetin ligjor të institucionit përkatës të palës tjetër kontraktuese, vetëm ose përmes institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshjeje.

5. Dokumentet zyrtare, vërtetimet, të cilat në zbatim të kësaj marrëveshjeje i lëshojnë organet apo institucionet e njëjës palë kontraktuese, konsiderohen të vlefshme edhe për organin apo institucionin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 32

Pagesa e përfitimeve

1. Institucioni kompetent për dhënien e përfitimit sipas kësaj marrëveshjeje, e realizon pagesën e përfitimit për përfituesit, në monedhën e vet kombëtare.

2. Transferimi i përfitimeve në monedhën e palës tjetër kontraktuese kryhet sipas kursit të këmbimit që është i vlefshëm ditën kur institucioni kompetent për dhënien e përfitimeve i kalon fondet organit pagues në shtetin e vet, për



dhënien pagesës përfituesit në shtetin tjetër kontraktues.

3. Përfitimet në para, të parashikuara me këtë marrëveshje, paguhen në monedhën e asaj pale kontraktuese, në të cilën ndodhet institucioni zbatues, tek i cili kalojnë përfitimet.

4. Pagesa e parashikuara me paragrafët 1 deri 3 të këtij neni, kryhen në monedhën e konvertuar në përputhje me qarkullimin monetar midis dy palëve kontraktuese.

Neni 33

Kërkesa për përfitime të paguara më tepër

1. Institucioni i njëjës palë kontraktuese, i cili ka paguar përfitimet në masë më të madhe se ajo që i takon përfituesit, në bazë të dispozitave ligjore, mund t'i kërkojë institucionit të palës tjetër kontraktuese, që të mbajë pjesën e përfitimit që i është dhënë më tepër përfituesit.

2. Shuma e paguar tepër, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i kalon direkt institucionit i cili ka kërkuar mbajtjen e saj.

Neni 34

Procedura ekzekutive

1. Vendimet ekzekutive në fushën e sigurimeve shoqërore të organeve dhe institucioneve kompetente, si dhe vendimet ekzekutive të gjykatave të njëjës palë kontraktuese njihen edhe nga pala tjetër kontraktuese.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm nëse është në kundërshtim me rendin publik të palës kontraktuese në të cilën duhet të njihet akti ose vendimi ekzekutiv, të parashikuar me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Aktet dhe vendimet ekzekutive, prej paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen në përputhje me dispozitat ligjore që lidhen me vendimet ose aktet ekzekutive të palës kontraktuese në të cilën duhet të zbatohen. Vendimet ose aktet ekzekutive duhet të përmbajnë vërtetimin që konfirmon zbatueshmërinë e tyre.

4. Zbatim i paragrafëve 1 deri 3 të këtij neni nuk e përfshin përfaqësimin në procesin gjyqësor.

Neni 35

Kompensimi i dëmit

1. Nëse në person, i cili sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese merr përfitime për shkak të dëmit të shkaktuar në palën tjetër kontraktuese, sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të palës së parë kontraktuese dhe nëse institucioni ka të drejtën e kompensimit të dëmit prej personit të tretë, atëherë e drejta e këtij kompensimi i kalon institucionit të palës së parë kontraktuese, nëse kjo është parashikuar sipas dispozitave të saj ligjore.

2. Nëse e drejta e kompensimit të dëmit lidhet me përfitime të njëjta, për të njëjtin rast të dëmit të kaluar tek institucionet e të dyja palëve kontraktuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi i tretë mund t'ia paguajë kompensimin e dëmit me vullnet të lirë, njërit apo tjetrit institucion, në proporcion me përfitimet që janë paguar.

Neni 36

Mbrojtja e të dhënave

Institucionet e të dyja palëve kontraktuese përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të shkëmbejnë të dhëna personale. Të dhënat personale të individëve, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të shkëmbehen nga njëra palë kontraktuese te pala tjetër, në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për realizimin e të drejtës së përfitimeve të parashikuar me këtë marrëveshje. Të gjitha shkëmbimet e të dhënave mes palëve kontraktuese do të jenë me përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të të dyja palëve kontraktuese.

Neni 37

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të dalin gjatë zbatimit dhe interpretimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhin nga organet kompetente të palëve kontraktuese nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të përbashkëta.



PJESA V
DISPOZITA KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 38
Dispozitat kalimtare

1. Kjo marrëveshje zbatohet edhe për rastet e të siguruarve që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të saj.

2. Kjo marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë përfitimi për rastet e ndodhura para hyrjes në fuqi të saj.

3. Të gjitha periudhat e sigurimeve, të realizuara sipas dispozitave ligjore të njëjës palë kontraktuese para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, merren në konsideratë në përcaktimin e së drejtës së përfitimit, të fituara në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

4. Kjo marrëveshje nuk zbatohet për të drejtat që janë shlyer me miratimin e një shume bazë ose kontributeve të kthyera.

Neni 39
Hyrja në fuqi

1. Palët kontraktuese, në mënyrë të ndërsjellë, me shkresë zyrtare, në rrugë diplomatike, do të njoftohen për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore që janë të domosdoshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit vijues pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 40
Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohore të përcaktuar.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet vetëm me miratimin e dyanshëm të palëve kontraktuese, përmes shkresave zyrtare. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi sipas procedurës dhe mënyrës që parashikohet në nenin 39 të kësaj marrëveshjeje.

3. Kjo marrëveshje mund të shfuqizohet me miratimin e dyanshëm të palëve kontraktuese ose në mënyrë të njëanshme, me shkresë zyrtare të dorëzuar në rrugë diplomatike, Në këtë rast marrëveshja do të shfuqizohet pas gjashtë muajsh

pas marrjes së shkresës zyrtare nga pala tjetër kontraktuese.

Në rast të shfuqizimit, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të vazhdojnë të zbatohen për rastet që lidhen mbi të drejtat e fituara, si dhe në lidhje me kërkesat për realizimin e të drejtave të paraqitura para marrjes së miratimit të dyanshëm për shfuqizim, respektivisht para dorëzimit të njoftimit me shkrim nga njëra palë për shfuqizimin e kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Shkup, më 17 mars 2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe maqedonase, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.

LIGJ
Nr. 124/2015

PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREUI
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) hartimi i rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë;

b) vendosja e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë;

c) rritja e konkurrueshmërisë së operatorëve.

* Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për efikasitetin e energjisë, që ndryshon direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE". Numri CELEX-32012L0027, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.315/1, datë 14.11.2012.



Neni 2 Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe personave fizikë dhe /ose juridikë, publikë ose privatë, që ushtrojnë veprimtari në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit, bujqësisë, si dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë, për nxitjen e përdorimit me efikasitet të energjisë dhe për zhvillimin e tregut për shërbimet energjetike.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për subjektet e mëposhtme:

- a) personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë;
- b) personat fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë, që janë konsumatorë fundorë të energjisë;
- c) personat fizikë dhe/ose juridikë, që sigurojnë shërbimet energjetike për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Auditim energjetik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.
2. “Auditues energjetik” është një person fizik ose juridik i licencuar për të kryer auditime energjetike.
3. “Agjencia për Efikasitetin e Energjisë” është institucioni përgjegjës për promovimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave e të politikave të efikasitetit të energjisë.
4. “Energji” është çdo formë energjie e disponueshme në treg, përfshirë energjinë elektrike, gazin natyror (përfshirë gazin natyror të

lëngshëm), gazin e lëngshëm të naftës, çdo lëndë djegëse për ngrohje dhe ftohje (përfshirë ngrohjen dhe ftohjen e përqendruar e rajonale), qymyrin dhe linjitin, torfën, karburantet për transport (duke përfshirë karburantet e përdorura në aviacion dhe transportin detar), biomasën, energjinë diellore, energjinë e erës, energjinë gjeotermale dhe energjinë nga mbetjet urbane.

5. “Efikasiteti i energjisë” është rezultati, në përqindje, i raportit ndërmjet sasisë së energjisë në dalje me sasinë e energjisë në hyrje.

6. “Fondi i Efikasitetit të Energjisë” është fondi i krijuar sipas këtij ligji.

7. “Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

8. “Financimi nga palë të treta” është një kontribut financiar që i sigurohet përfituesit nga një palë e tretë, e ndryshme nga furnizuesi i energjisë, e cila siguron kapitalin financiar për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, duke i ngarkuar përfituesit detyrimin e një pagese që llogaritet mbi bazën e përfitimit që arrihet si rezultat i zbatimit të masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

9. “Intensiteti i energjisë” është raporti i konsumit vjetor të energjisë nga konsumatorët fundorë me prodhimin e brendshëm bruto (GDP) të vendit.

10. “Konsumator fundor” është një person fizik ose juridik që blen energji vetëm për nevojat e tij.

11. “Konsumator i madh i energjisë” është një konsumator fundor, i cili, në bazë të të dhënave të një procesi auditimi, rezulton se ka konsum vjetor të energjisë më të madh se ekuivalenti i 3 milionë kWh në vit.

12. “Konsumi primar i energjisë” është konsumi i brendshëm bruto i burimeve të energjisë, duke përfshirë burimet që përdoren për qëllime joenergjetike.

13. “Konsumi final i energjisë” është konsumi total i të gjitha llojeve të energjisë që furnizojnë konsumatorët fundorë, duke përfshirë konsumin e energjisë në sektorin e transformimit të energjisë dhe vetë industrinë energjetike.

14. “Kursim i energjisë” është sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar nëpërmjet matjes dhe/ose përlllogaritjes së konsumit, përpara dhe



pas implementimit të një mase përmirësimi eficiency, kur nuk ndryshojnë kushtet e jashtme që ndikojnë në konsumin e energjisë.

15. “Kontraktimi i performancës energjetike” është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe siguruesit të masave të përmirësimit të eficiency së energjisë, ku investimet në masa (puna, furnizimi apo shërbimi) paguhet nga përfituesi në raport me nivelin e përmirësimit të eficiency së energjisë, sikurse përcaktohet në marrëveshje.

16. “Masat e përmirësimit të eficiency së energjisë” është çdo masë që sjell përmirësime të verifikueshme dhe të matshme të eficiency së energjisë.

17. “Masa ndërsektoriale” është çdo masë e ndërmarrë nga subjektet publike e private, e cila ndikon në mënyrë të tërthortë në përmirësimin e eficiency së energjisë”.

18. “Ministri” është ministri përgjegjës për energjinë.

19. “Mekanizmat e eficiency së energjisë” janë mekanizmat që ndërmerren nga institucionet ose agjencitë shtetërore përgjegjëse për energjinë për të krijuar një kuadër ose skema mbështetëse për pjesëmarrësit e tregut për ofrimin dhe blerjen e shërbimeve të energjisë, si dhe masa të tjera të përmirësimit të eficiency së energjisë.

20. “Ndërtesë” është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm.

21. “Ndërtesë publike” është një ndërtesë në pronësi të shtetit ose në përgjegjësi administrimi nga një person juridik publik.

22. “Objekt industrial” është një ndërtesë e destinuar për ushtrimin e proceseve të ndryshme industriale.

23. “Përmirësimi i eficiency së energjisë” është rritja e eficiency në përdorimin fundor të energjisë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike dhe/ose sjelljeve ekonomike.

24. “Programe të përmirësimit të eficiency së energjisë” janë programe që synojnë financimin ose mbështetjen e veprimtarive, me qëllim përmirësimin e eficiency së energjisë, në grupe konsumatorësh fundorë.

25. “Performanca energjetike e një ndërtese” është sasia e përlllogaritur ose e matur e energjisë, e nevojshme për të plotësuar kërkesën për

energji, lidhur me një përdorim normal të ndërtesës, që përfshin, ndërmjet të tjerash, energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë dhe ndriçim.

26. “Produkt me ndikim në energji” është çdo produkt që ka një ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit të tij, përfshirë pjesët e projektuara për t’iu bashkuar produkteve me ndikim në energji, të cilat janë hedhur në treg ose janë vënë në punë si pjesë të veçanta për përdoruesit fundorë.

27. “Rinovim i konsiderueshëm” është një rinovimin, kostoja e të cilit kalon 50 për qind të koston të investimit që nevojitet aktualisht për një njësi të re të ngjashme me atë që rinovohet.

28. “Shërbime energjetike” është shërbimi dhe/ose produkti që përfitohet nga kombinimi i energjisë me teknologjinë e përdorur për përmirësimin e eficiency së energjisë dhe/ose masat, të cilat përfshijnë operimet, mirëmbajtjen dhe kontrollin e nevojshëm për të siguruar eficiency e energjisë, sipas një kontrate, që vërtetohet se sjell përmirësime të verifikueshme dhe të matshme, ose të përlllogaritura të eficiency së energjisë dhe/ose kursime të energjisë primare.

29. “Shoqëri e shërbimeve energjetike” është një person juridik që ofron shërbime energjetike dhe/ose masa të tjera të përmirësimit të eficiency së energjisë.

30. “Shpërndarës energjie” është një person juridik, përfshirë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, përgjegjës për transportin e energjisë, me qëllim lëvizimin e energjisë konsumatorëve fundorë, apo stacione shpërndarjeje që u shesin energji konsumatorëve fundorë.

KREU II

POLITIKAT E EFIÇENCËS SË ENERGIJË

Neni 5

Politikat e eficiency së energjisë

1. Në politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë përcaktohen drejtimet për arritjen e objektivave kryesorë kombëtarë, mekanizmat, incentivat, aftësitë institucionale dhe financiare, si dhe kuadri i duhur ligjor për shmangien e çdo barriere ekzistuese tregu për përmirësimin e eficiency së energjisë në vend.



2. Politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë synojnë nxjerrjen e përfitimeve maksimale, përgjatë gjithë zinxhirit të përdorimit të energjisë, përfshirë prodhimin, transformimin, depozitimin, transmetimin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në forma të ndryshme.

3. Politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë duhet të marrin në konsideratë:

a) sigurimin e operimit normal të tregut energjetik, sipas kriterëve konkurruese të bazuara në kosto, si dhe të përfitimeve të mbrojtjes mjedisore.

b) promovimin e efikasitetit të energjisë nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të ndryshëm financiarë, përfshirë edhe incentivat përkatëse, si dhe nxitjen e investimeve në këtë fushë;

c) transformimin e sektorit publik në një shembull model në menaxhimin eficient të energjisë, nëpërmjet investimeve, mirëmbajtjes, përdorimit të pajisjeve efikente që konsumojnë energji, shërbimeve energjetike dhe masave të tjera të përmirësimit të efikasitetit të energjisë;

ç) edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut e të përdoruesve të energjisë, lidhur me nevojën dhe përfitimet nga reduktimi i konsumit joeficient dhe joekonomik i energjisë;

d) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet konsumatorëve, prodhuesve, furnizuesve të energjisë dhe subjekteve publike, me qëllim arritjen e objektivave të vendosur në politikat kombëtare të përdorimit eficient të energjisë;

dh) mbështetjen e kërkimeve dhe adoptimin e teknologjive të reja në bashkëpunim me institucionet shkencore dhe ato universitare në fushën e përdorimit eficient të energjisë;

e) promovimin e iniciativave private dhe zhvillimin e shërbimeve me kosto efektive të efikasitetit dhe ruajtjes së energjisë;

ë) shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe respektimin e prioritetëve sociale në promovimin e efikasitetit të energjisë, mbi bazën e ndryshimeve teknologjike, kulturore dhe/ose ekonomike;

f) bashkëpunimin me vendet e tjera në fushën e efikasitetit të energjisë dhe përmbushjen e angazhimeve e të detyrimeve të vendit, në kuadrin e çdo traktati ose konvente ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë.

4. Gjatë hartimit të politikave dhe programeve të efikasitetit të energjisë merren në konsideratë

karakteristikat e çdo rajoni të vendit dhe perspektivat e tyre për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

5. Ministria përgjegjëse për energjinë, me mbështetjen e Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, harton politikat kombëtare për efikasitetin e energjisë, si dhe monitoron zbatimin e këtyre politikave.

Neni 6

Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë

1. Këshilli i Ministrave, duke respektuar çdo angazhim të vendit tonë, si palë e Komunitetit të Energjisë dhe të procesit të integritit në Bashkimin Europian, vendos një objektiv kombëtar të kursimit të energjisë, që bazohet në mundësitë reale ekonomike, konsumin primar ose atë final të energjisë, kursimin e energjisë primare ose finale, intensitetin e energjisë.

2. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë duhet të arrihet nëpërmjet shërbimeve energjetike, që synojnë rritjen e efikasitetit të energjisë në sektorë të veçantë të ekonomisë, si rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë, dhe marrjes së masave të tjera ndërsektoriale.

3. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë përcaktohet në Planin Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë.

Neni 7

Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

1. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë hartohet nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë rishikohet çdo tre vjet dhe një kopje e tij i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë përmban:

a) objektivin për rritjen e efikasitetit të energjisë;

b) objektivat e ndërmjetëm për çdo tre vjet;

c) analizën dhe vlerësimin e arritjeve të planit të mëparshëm;

ç) treguesit paraprakë dhe objektivat e veçantë për kursimin e energjisë në çdo sektor;



d) veprimet dhe masat specifike të parashikuara për arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe të ndërmjetëm kombëtarë të efikasitetit të energjisë;

dh) detyrimet e organeve qendrore dhe vendore, lidhur me përmbushjen e veprimeve të parashikuara për rritjen e efikasitetit të energjisë;

e) listën e akteve ligjore dhe nënligjore për arritjen e objektivave të efikasitetit të energjisë;

ë) afatet kohore për përmbushjen e detyrimeve përkatëse;

f) burimet e financimit, që do të përdoren për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;

g) informacion në lidhje me investimet e individëve, industrinë e ndërtimit dhe institucionet financiare;

gj) një vlerësim të bazuar të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve të tjera që krijohen nga kursimi, në rast të marrjes së masave për rritjen e efikasitetit të energjisë;

h) treguesit e performancës për vlerësimin e rezultateve të arritura dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për këtë qëllim;

i) objektiva afatgjatë për realizimin e investimeve në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrialë, të transportit e të bujqësisë, në funksion të efikasitetit të energjisë.

Neni 8

Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

1. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë monitoron zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të masave për efikasitetin e energjisë. Mbikëqyrja e zbatimit të masave për kursimin e energjisë kryhet në bazë të metodologjisë së llogaritjes së kursimit të energjisë, bazuar në treguesit e efikasitetit të energjisë në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrialë, të transportit e të bujqësisë, e cila miratohet me udhëzim të ministrit.

2. Çdo veprimtari monitorimi, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet bazuar mbi treguesit që gjenden në bazën e të dhënave kombëtare të energjisë. Në rast se tregues të caktuar nuk gjenden në bazën e të dhënave kombëtare, për qëllim monitorimi përdoren të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat zbatohen nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

3. Forma dhe shpeshësia e paraqitjes së raportimit mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përcaktohen me urdhër të ministrit.

4. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë raporton në ministri për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, përfshirë rezultatet dhe objektivat e arritur, si dhe problemet e pengesat e hasura.

5. Ministri raporton një herë në vit në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë.

Neni 9

Masat për efikasitetin e energjisë në sektorin publik dhe masat ndërsektoriale

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përfshin në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifikime teknike, që përmbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji.

2. Në rastet kur për një produkt nuk ekziston asnjë standard teknik shqiptar për efikasitetin e energjisë, zbatohet standardi teknik për efikasitetin e energjisë i Bashkimit Evropian, që është në fuqi për atë produkt.

3. Masat ndërsektoriale zbatohen nga subjektet publike dhe private përgjegjëse dhe përfshijnë, ndërmjet të tjerave:

a) miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, në përmirësimin e efikasitetit të energjisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesat;

b) skemat e etiketimit të energjisë;

c) matjen, sistemet inteligjente të matjes, të tilla si pajisjet individuale të matjes, të menaxhuara nga larg dhe sistemet informuese të faturimit;

ç) trajnimin dhe edukimin, që çon në aplikimin e teknologjisë dhe/ose teknikave të efikasitetit të energjisë;



d) rregulloret, taksat, që kanë efektin e reduktimit të konsumit final të energjisë;

dh) fushatat që fokusohen në informimin dhe promovimin e përmirësimit të efikasitetit të energjisë dhe masat që duhen ndërmarrë, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Neni 10

Menaxheri i energjisë

1. Personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie.

2. Menaxheri i energjisë është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, përmirësimin dhe mbikëqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

3. Menaxheri i energjisë duhet të ketë kualifikimet dhe njohuritë profesionale, si dhe eksperiencë praktike në kursimin e energjisë.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.

Neni 11

Masat për kursimin e energjisë nga konsumatorët e mëdhenj

1. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë marrin masa për përmirësimin e menaxhimit të energjisë, si dhe formulojnë e zbatojnë masa teknike për kursimin e energjisë, me synim reduktimin e konsumit të energjisë.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, përveç objektivave sektoriale të kursimit të energjisë, parashikon objektivat individuale për kursimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj.

Neni 12

Marrëveshjet vullnetare

1. Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë dhe Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, për dhënien e mbështetjes për marrjen dhe zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë.

2. Marrëveshjet vullnetare, referuar pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë transparente, jodiskriminuese dhe të përmbajnë informacion lidhur me

objektivat sasiorë të vendosur, si dhe procesin e monitorimit e të raportimit.

3. Kur palët kanë lidhur një marrëveshje vullnetare dhe Agjencia vlerëson nevojën e dhënies së mbështetjes financiare për kryerjen e një procesi auditimi energjetik ose për zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë, ajo i propozon Fondit për Efikasitetin e Energjisë që një pjesë të kostove të këtyre proceseve të financohen nga Fondi.

4. Çdo marrëveshje vullnetare e nënshkruar sipas këtij, neni hyn në fuqi vetëm mbas miratimit nga ministri përgjegjës për energjinë.

KREU III

INFORMACIONI PËR EFIKASITETIN E ENERGISË DHE MATJA

Neni 13

Baza e të dhënave të energjisë

1. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë krijon dhe përditëson një bazë të dhënash kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtet në kursimin saj, sipas formatit të miratuar nga ministri.

2. Baza e të dhënave të energjisë, e krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efikasitetit të energjisë, sipas këtij ligji.

3. Shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë i paraqesin Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, të paktën një herë në vit, informacione të përmbledhura statistikore mbi klientët e tyre fundorë.

4. Informacioni, sipas pikës 3, të këtij neni, përmban informacion historik dhe aktual lidhur me konsumin e përdoruesve fundorë, përfshirë, kur është e mundur, profile të ngarkesës, segmentimin e klientëve dhe vendndodhjen gjeografike të tyre, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit, që është i karakterit privat ose i ndjeshëm nga pikëpamja tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë janë të detyruar të dërgojnë pranë Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, një raport me të dhëna mbi konsumin e tyre të energjisë për vitin kalendarik paraardhës.

6. Konsumatorët e tjerë të energjisë, që nuk kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj, janë të detyruar t'i dërgojnë Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti,



konsumin e tyre aktual të energjisë, kur kjo u kërkohet.

7. Për sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë, Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në bashkëpunim me INSTAT-in, bën sondazhe mbi të dhënat për konsumin e energjisë nga konsumatorët në këta sektorë.

8. Ministri miraton formën dhe afatet e paraqitjes së të dhënave dhe informacionit, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 14

Matja

1. Agjencia për Efiçencën e Energjisë i kërkon subjekteve që kanë në përgjegjësi administrimi ndërtesa apo objekte industriale, të marrin masa për pajisjen e konsumatorëve fundorë me matës individualë të konsumit përfundimtar të energjisë, për çdo formë energjie që shpërndahet nga një rrjet qendror.

2. Aty ku përdorimi i matësve individualë nuk është teknikisht i realizueshëm dhe aty ku ndërtesat me shumë apartamente furnizohen nga rrjeti i ngrohjes/ftohjes qendrore apo ku sistemet e ngrohjes/ftohjes janë të përbashkëta, Agjencia për Efiçencën e Energjisë harton rregulla transparente për ndarjen e konsumit të energjisë termike te konsumatorët fundorë.

3. Ministri, me propozimin e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, miraton një udhëzim për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike, siç parashikohet nga ky nen.

Neni 15

Informacioni dhe trajnimi

1. Agjencia për Efiçencën e Energjisë publikon, nëpërmjet faqes së saj zyrtare të internetit, ose botimeve të ndryshme, çdo informacion për mekanizmat e efiçencës së energjisë dhe kuadrin financiar e ligjor të miratuar, me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të kursimit të energjisë.

2. Agjencia për Efiçencën e Energjisë informon konsumatorët fundorë për metodat dhe praktikat e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.

3. Agjencia për Efiçencën e Energjisë organizon trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, përfaqësuesit e autoriteteve vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë

mbi legjislacionin për efiçencën e energjisë, si dhe për masat për implementimin e këtij legjislacioni.

4. Ministri miraton një udhëzim mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit që do të vihet në dispozicion nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, siç parashikohet nga ky nen.

KREU IV

AUDITIMET DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE

Neni 16

Auditimi energjetik

1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjie të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë.

2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin:

a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik;

b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik;

c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme;

ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efiçencës së energjisë dhe masat teknike përkatëse.

3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efiçencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm.

4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;

b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni;

b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

6. Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie dhe është subjekt i auditimit të detyruar, duhet që, brenda dy vjetësh nga marrja e rezultateve të auditimit, të ndër-



marrë masat dhe kryejë veprimet e rekomanduara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

7. Personat fizikë ose juridikë, subjekt i auditimit energjetik, paguajnë shpenzimet e kryera nga audituesi, si dhe shpenzimet për zbatimin e masave të dhëna nga audituesi për kursimin e energjisë.

8. Format i auditimit energjetik dhe pagesa për audituesin energjetik përcaktohen në rregulloren e hartuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë dhe të miratuar nga ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin.

Neni 17

Audituesi energjetik

1. Audituesi energjetik është një person fizik ose juridik, i licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit e të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet licenca e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkaillës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

4. Audituesi energjetik mban konfidencialitetin të gjitha të dhënat lidhur me personin fizik ose juridik, të përftuara në kuadrin e auditimit të kryer në objektet energjetike të këtij personi. Audituesi energjetik nuk duhet të përfitojë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë në interes ose në dëm të subjektit të audituar apo të një pale të tretë. Detyrimi i konfidencialitetit mund të hiqet me miratimin me shkrim nga personi fizik ose juridik, objekt i auditimit energjetik, ose nëse bërja publike e tyre parashikohet nga një ligj tjetër.

5. Përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, një licencë për auditimin energjetik revokohet nga ministri përgjegjës për energjinë, me iniciativën e tij ose me propozimin e Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, pas një procedure në përputhje me legjislacionin në fuqi, që i garanton audituesit të licencuar të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u ankuar lidhur me shkeljen, në rast se:

a) provohet se në procesin e auditimit energjetik janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore;

b) provohet se audituesi bën publik informacionin dhe të dhënat e shoqërisë, si dhe sekretet tregtare të konsumatorëve, me të cilat ai është njohur për shkak të auditimit, me kusht që publikimi i tyre të jetë ankimuar nga subjekti i audituar.

6. Ministri njofton me shkrim audituesin energjetik për vendimin e tij për revokimin e licencës, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Një person, licenca e të cilit është revokuar, ka të drejtë të aplikojë për një licencë të re nëse përmbush kriteret për të qenë auditues, jo më herët se një vit nga data e marrjes së vendimit për revokimin e licencës.

Neni 18

Shërbimet energjetike

1. Në shërbimet energjetike përfshihen një ose më shumë veprimtari apo masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

2. Shërbimet energjetike ofrohen nga subjekte të licencuara për ofrimin e shërbimeve energjetike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. Ministria përgjegjëse për energjinë mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të ofruesve të shërbimeve energjetike.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit për shoqëritë, të cilave u lëshohet licenca e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Shërbimet energjetike sigurohen mbi bazën e kontraktimit të performancës energjetike me terma dhe kushte të negociuara lirisht midis palëve, përveçse kur ato ofrohen në kuadrin e një



programi të financuar nga Fondi i Efiçencës së Energjisë.

5. Ministri, me propozimin e Agjencisë së Efiçencës së Energjisë, miraton kontrata standarde për shërbimet energjetike, të siguruara në kuadrin e një programi të financuar nga Fondi i Efiçencës së Energjisë.

KREU V

FONDI PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

Neni 19

Fondi për Efiçencën e Energjisë

1. Fondi për Efiçencën e Energjisë është person juridik, gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse dhe e ka selinë në Tiranë.

2. Fondi ka për qëllim dhënien e mbështetjes financiare në rastet e kryerjes së investimeve për marrjen e masave për përmirësimin e efiçencës së energjisë.

3. Për arritjen e qëllimeve të tij, Fondi mbështetet në parimet e vetëfinancimit, transparencës në administrimin e pasurisë, të trajtimit të barabartë të të gjithë përfituesve të Fondit, partneritetit dhe bashkëpunimit me sektorin privat për bashkëfinancimin e projekteve të investimeve për efiçencën e energjisë.

4. Nga ky Fond mund të përfitojnë shoqëritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji, konsumatorët fundorë, shoqëritë e shërbimeve energjetike dhe siguresit e masave të përmirësimit të efiçencës së energjisë.

Neni 20

Organizimi i Fondit

1. Organet drejtuese të Fondit janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

2. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit dhe përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

3. Drejtori Ekzekutiv është autoriteti më i lartë ekzekutiv i Fondit, i cili emërohet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit dhe përgjigjet përpara tij. Afati i qëndrimit në detyrë të Drejtorit Ekzekutiv është 5 vjet, me të drejtë rrizgjedhjeje.

4. Kriteret për emërimin e Këshillit Drejtues dhe të Drejtorit Ekzekutiv, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Administrata e Fondit funksionon në përputhje me statutin dhe manualin e procedurave të Fondit. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Fondit rregullohen sipas Kodit të Punës.

6. Rregullat e funksionimit të Fondit përcaktohen në statut dhe në manualin e procedurave të Fondit.

Neni 21

Detyrat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka këto detyra:

a) miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë së Fondit;

b) miraton statutin dhe manualin e procedurave të Fondit;

c) miraton marrëveshjet e zbatimit dhe/ose të financimit të projekteve;

ç) emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv, në përputhje me parashikimet e statutit;

d) mbikëqyr administrimin dhe veprimtarinë e Fondit;

dh) miraton strukturën organizative të Fondit;

e) miraton kushtet dhe kriteret bazë të marrëdhënieve të punësimit në Fond, përfshirë strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve;

ë) miraton bilancin vjetor, raportet vjetore dhe raportet periodike të veprimtarisë së Fondit;

f) miraton buxhetin vjetor të Fondit;

g) analizon dhe miraton raportet e kontrolleve të kryera për veprimtarinë e Fondit;

gj) merr vendime për çështje që lidhen me veprimtarinë e Fondit dhe miraton dokumentet e nevojshme për ecurinë e kësaj veprimtarie.

2. Këshilli Drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 22

Detyrat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ka këto detyra:

a) është përfaqësuesi ligjor i Fondit;

b) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të Fondit dhe ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;

c) administron burimet financiare të Fondit;

ç) nënshkruan marrëveshjet me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe donatorë të ndryshëm;

d) emëron dhe shkarkon personelin, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 21, shkronja “e”, të këtij ligji;



dh) kërkon thirrjen e mbledhjeve të jashtë-zakonshme të Këshillit Drejtues;

e) kryen të gjitha detyrat e tjera të ngarkuara në bazë të këtij ligji, të statutit dhe të manualit të procedurave të Fondit.

Neni 23

Financimi i Fondit

1. Fondi financohet nga:

a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve, të zbatuara nga Fondi i Efiçencës së Energjisë;

b) fondet nga Buxheti i Shtetit;

c) fonde nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse;

ç) të ardhurat e përfituara nga aktivet e saj dhe shërbimet e ofruara;

d) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Fondi i përdor të ardhurat e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në manualin e procedurave të Fondit.

Neni 24

Programet e financuara nga Fondi për Efiçencën e Energjisë

1. Fondi për Efiçencën e Energjisë përdoret për financimin e programeve të mëposhtme, të cilat duhet të jenë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë:

a) investimet që synojnë përmirësimin e efiçencës së energjisë në konsumatorët fundorë;

b) investimet që synojnë përmirësimin e efiçencës së energjisë në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë;

c) përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndriçimin publik;

ç) përmirësimin e efiçencës së energjisë në furnizimin me ujë dhe sistemet e trajtimit të ujrave të zeza;

d) zhvillimin e projekteve pilot, me qëllim për të studiuar dhe testuar teknologji të reja të energjisë ose zgjidhje të reja organizative për sektorin e energjisë;

dh) auditimet e energjisë që do të kryhen në sektorin publik;

e) përmirësimin e matjes dhe informacionit në faturim;

ë) kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e efiçencës së energjisë;

f) fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitetet e edukimit në lidhje me efiçencën e energjisë;

g) programet që financohen në kuadër të marrëveshjeve vullnetare, të propozuara nga Agjencia.

2. Fondi mund të parashikojë dhënien e granteve, kredive, garancive financiare dhe/ose lloje të tjera të financimit që garantojnë rezultate. Kontributet e Buxhetit të Shtetit jepen vetëm për financime të projekteve specifike. Këto kontribute përdoren sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Fondi vlerëson, rast pas rasti, propozimin e Agjencisë për mbështetjen financiare, sipas parashikimeve të nenit 12, pika 3, të këtij ligji, sipas procedurës së përcaktuar në manualin e procedurave të Fondit.

4. Çdo fond që përdoret për financimin e shërbimeve të energjisë i nënshtrohet procedurave të hapura konkurruese, sipas legjislacionit në fuqi dhe parashikimeve të përcaktuara në manualin e procedurave të Fondit.

5. Fondi deklaron pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë çdo të dhënë reale të përmirësimit të efiçencës së energjisë, që rezultojnë pas marrjes së masave të financuara prej tij.

6. Konsumatorët fundorë që përfitojnë financime nga palë të treta, të ndryshme nga Fondi për Efiçencën e Energjisë, dhe/ose palët e treta që sigurojnë këto financime deklarojnë pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë çdo të dhënë reale të përmirësimit të efiçencës së energjisë, që rezultojnë pas marrjes së masave.

7. Çdo fond në llogarinë e Fondit të Efiçencës së Energjisë, që nuk shpenzohet gjatë një viti, transferohet për vitin pasardhës.

KREU VI

AGJENCIA PËR EFIÇENCËN E ENERGISË

Neni 25

Agjencia për Efiçencën e Energjisë

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, krijon Agjencinë për Efiçencën e Energjisë, si institucion në varësi të ministrit



përgjegjës për energjinë, dhe përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.

2. Agjencia për Eficiencën e Energjisë është person juridik publik, i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera financimi jashtë Buxhetit të Shtetit, përfshirë burimet e financimeve të huaja, nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme për promovimin e eficiencës dhe kursimit të energjisë.

3. Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për eficiencën e energjisë dhe ka detyrat e mëposhtme:

a) të përgatisë, të zbatojë dhe të monitorojë politikat dhe programet për përdorimin eficient të energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë;

b) të përgatisë dhe të monitorojë Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;

c) t'i paraqesë çdo vit ministrit një raport të hollësishëm lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;

ç) të bashkëpunojë me autoritetet qendrore dhe vendore, shoqëritë që operojnë në objektet industriale dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e bazës së nevojshme të të dhënave të energjisë, përfshirë llogaritjen e treguesve të eficiencës së energjisë, si dhe për zbatimin e masave për nxitjen e eficiencës së energjisë;

d) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit aktet e nevojshme nënligjore për nxitjen e eficiencës së energjisë, siç parashikohet në këtë ligj;

dh) të përgatisë standardet, normat dhe rregulloret teknike, me qëllim rritjen e eficiencës së energjisë së pajisjeve, aparaturave dhe makinerive që përdoren për prodhimin, transportin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit e të bujqësisë;

e) të vlerësojë teknikisht projektet e investimeve në fushën e eficiencës së energjisë, të paraqitura pranë Fondit nga subjektet e interesuara;

ë) të lidhë marrëveshje vullnetare sipas përcaktimeve të nenit 12, pika 3, të këtij ligji;

f) t'i propozojë Fondit dhënie e mbështetjes financiare për projektet që aplikojnë për financime nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të brendshme ose të jashtme për marrjen e masave për eficiencën e energjisë, sipas parashikimeve të

nenit 12, pika 3, të këtij ligji;

g) të përgatisë kontrata standarde për shërbime energjetike që financohen nga Fondi, të cilat miratohen nga ministri dhe t'i publikojë ato në faqen e saj zyrtare;

gj) të koordinojë programet e eficiencës së energjisë, të financuara nga institucionet ose organizatat ndërkombëtare, mbështetur në marrëveshjet qeveritare;

h) të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim përdorimin me eficiencë të energjisë dhe reduktimin e ndikimit negativ në mjedis;

i) të këshillojë autoritetet e administratës publike vendore, administratorët e ndërtesave publike dhe atyre me destinacion banimi për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të eficiencës së energjisë;

j) të bashkëpunojë me organet akredituese, për marrjen e informacionit mbi rezultatet e testeve dhe matjeve, për përmbushjen e standardeve kombëtare të eficiencës së energjisë;

k) të zhvillojë dhe të koordinojë programet e trajnimit;

l) të këshillojë konsumatorët fundorë për programet e eficiencës së energjisë të ndërmarra prej tyre;

ll) të mbështesë dhe të këshillojë kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe veprimtarive të tjera edukative lidhur me nxitjen e eficiencës dhe kursimit të energjisë;

m) të verifikojë, në rast se e çmon të nevojshme, saktësinë e të dhënave të raporteve të hartuara nga një auditues energjetik;

n) të vendosë masat administrative, sipas nenit 26 të këtij ligji.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mosparaqitja e raporteve, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve dhe të dhënave të falsifikuara nga shoqëritë që ofrojnë shërbime energjetike, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 1 000 000 lekë;



b) mosraportimi nga konsumatorët e mëdhenj, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve apo të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

c) mosraportimi nga konsumatorët e tjerë, që nuk kategorizohen si konsumator të mëdhenj, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 13, të këtij ligji, ose paraqitja e raporteve apo të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 15 000 lekë;

ç) shkelja e detyrimeve të përcaktuara në pikat 3 dhe 5, të nenit 17, të këtij ligji, nga audituesit energjetikë, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

d) shkelja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 24, të këtij ligji, nga Fondi për Eficiencën e Energjisë, ose paraqitja e të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 1 000 000 lekë;

dh) mosraportimi nga konsumatorët fundorë, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 24, të këtij ligji, ose paraqitja e të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

e) mosraportimi nga palët e treta, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 24, të këtij ligji, ose paraqitja e të dhënave të falsifikuara, dënohet me gjobë 500 000 lekë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

3. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i masave administrative, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 27

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 1; 10, pika 4; 17, pika 2; 18, pika 3; 20, pika 4 dhe 25, pika 1.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5; 8 pikat 1 dhe 3; 13, pika 8; 14, pika 3; 15, pika 4 dhe 18, pika 5.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të nenit 16, pika 8.

Neni 28

Dispozita kalimtare

1. Deri në krijimin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, ministria është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj.

2. Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 29

Shfuqizimi i akteve të tjera

Ligji nr. 9379, datë 28.4.2005, “Për eficiencën e energjisë”, dhe çdo dispozitë ligjore, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9325, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 98/2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 5/2015 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës e të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Përparim Spahiu caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.



II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj

Miratuar në datën 19.11.2015

VENDIM
Nr. 946, datë 24.11.2015

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË FËMIJËS KRISTI MAZE,
NË SPITALIN “PAPA GIOVANNI
XXIII”, NË BERGAMO, ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Kristi Maze, në masën 16 400 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, në spitalin “Papa Giovanni XXIII”, në Bergamo, Itali.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2015.

3. Pagesa për trajtimin e fëmijës të bëhet në llogarinë bankare të spitalit “Papa Giovanni XXIII”, kundrejt dokumenteve financiare zyrtare, të lëshuara nga ky institucion.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë